



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK TË PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT TË GARANCISË EVROPIANE PËR FËMIJËT 2026-2030

1. Titulli i projekt-aktit

Vendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Garancinë Evropiane për Fëmijët 2026 - 2030

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Konsultimi për Planin Kombëtar të Veprimit për Garancinë Evropiane për Fëmijët 2026 – 2030, është zhvilluar në dy faza: në fazën e parë të shtrirë në periudhën prill-korrik 2025, u identifikuan nevojat dhe prioritetet e më pas gjatë periudhës shtator-nëntor janë zhvilluar takime të ngushta teknike tematike me stafet e ministrive, institucionet arsimore, bashkitë, ofruesit e shërbimeve të shëndetit parësor, fëmijët dhe prindërit, me shoqërinë civile, ministrinë e linjës dhe agjencitë përkatëse dhe me anëtarët e Grupit të Teknik Ndërinstitucional të Punës.

3. Metodat e konsultimit

Për konsultimin publik të PKV GF 2026-2030 u përdorën metodat si më poshtë:

- Konsultime në kuadër të Urdhrit të të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nr. 577, datë 8 nëntor 2024, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për ngritjen e Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës”.
- Konsultime me grupe teknike në secilën ministri përgjegjëse, drejtuar nga Zëvendësministrat e fushës përkatëse
- U-report, anketa, fokus grupe për konsultimet me fëmijët (gjatë mbledhjes së nevojave dhe identifikimit të prioritetëve dhe më pas konsultimin e draft planit
- Fokus grupe me prindër në bashkitë Vlorë, Vorë, Kukës dhe Korçë.
- Takime konsultative me aktorë publike e jo-publike
- Mendime/sugjerime të ndara përmes emailit.

4. Palët e interesuara të përfshira

Në kuadër të konsultimit publik kanë ardhur komente, nëpërmjet e-mailit zyrtar, sugjerime dhe komente nga:

- NISMA ARSIS
- MEDPAK
- CRCA

Komentet dhe sugjerimet e mëposhtme janë dërguar përmes komunikimeve të drejtpërdrejta me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi	Arsyetimi
7. Aksesit në shërbime 7.1 Mbrojtja e fëmijëve, paragrafi “Megjithatë, pengesat për akses në mbrojtje dhe shërbime mbeten të mëdha dhe sistematike, sidomos për fëmijët që jetojnë në varfëri, kanë aftësi të kufizuara, janë pjesë e pakicave etnike, janë migrantë apo pa kujdes prindëror”	Sygjerohet përfshirjen e fëmijëve në situatë rruge, migrim i brendshëm, shfrytëzim për lypje, në konflikt me ligjin, braktisjes së shkollës	NISMA ARSIS	Pranuar plotësisht	Grupet e fëmijëve të specifikuara janë të përfshira dhe të analizuara në pikat 5 dhe 6, të cilat kanë në fokus grupet e fëmijëve në rrezik varferie dhe perjashtimi social në Shqipëri, si dhe fokusi sipas rekomandimeve të Këshillit të BE
7. Aksesit në shërbime 7.1 Mbrojtja e fëmijëve, paragrafi “Fëmijët në kontekste migrimi: mungesë strehimore shtetërore, mbështetje vetëm nga OJF-të dhe mungesë standardesh”	Sygjerohet të specifikohet nëse bëhet fjalë për fëmijë të huaj të pashoqëruar	NISMA ARSIS	Pranuar plotësisht	Riformuluar si vijon: Fëmijët në kontekste migrimi (fëmijë të huaj të pashoqëruar): mungesë strehimore shtetërore, mbështetje vetëm nga OJF- të dhe mungesë standardesh.

<p>9. Objektivat prioritetet strategike</p> <p>1. Mbrojtja dhe mirëqenia e fëmijëve (fokus ndërsektorial)</p> <p>Objektivi Specifik 3: Garantimi i aksesit të fëmijëve në shërbime të integruara, cilësore dhe me bazë komunitare, përmes një ekipi profesional të punonjësve dhe bashkëpunimit ndërsektorial.</p>	<p>Sygjerim: përmirësim i kurrikulave dhe përafrim i tyre me standardet e BE</p> <p>Është e nevojshme që ASCK të marrë në konsideratë dhe të reflektojë në procedurat e veta qasjen ndaj shërbimeve sociale dhe ofruesve të shërbimeve sociale si psikologë dhe punonjës sociale.</p>	<p>NISMA ARSIS</p>		
<p>9. Objektivat prioritetet strategike</p> <p>1. Mbrojtja dhe mirëqenia e fëmijëve (fokus ndërsektorial)</p> <p>Objektivi Specifik 4: Të forcohet mirëqenia e fëmijëve dhe familjeve përmes mbështetjes gjithëpërfshirëse dhe shërbimeve të specializuara të mbrojtjes dhe me bazë komunitare për fëmijët në rrezik.</p>	<p>Duke qenë se ky objektivi konsideron trajtimin përmes shërbimeve të specializuara të mbrojtjes, mendoj se duhet të adresohet në përshkrimin e objektivit, elementët e dhunës apo rrezikut :</p> <p><i>Forcimi i mirëqenies së fëmijëve dhe familjeve përmes mbështetjes gjithëpërfshirëse dhe shërbimeve të specializuara të mbrojtjes dhe me bazë komunitare për fëmijët në rrezik.</i></p>	<p>NISMA ARSIS</p>	<p>Pranuar plotësisht</p>	<p><i>Riformuluar si në vijim:</i> Forcimi i mirëqenies së fëmijëve dhe familjeve përmes mbështetjes gjithëpërfshirëse dhe shërbimeve të specializuara të mbrojtjes dhe me bazë komunitare për fëmijët në rrezik</p>

<p>9. Objektivat prioritetet strategike</p> <p>1. Mbrojtja dhe mirëqenia e fëmijëve (fokus ndërsektorial)</p> <p>Objektivi Specifik 4, fjalia: Ky objektivi synon të promovojë mirëqenien afatgjatë të fëmijëve në situata të vështira përmes ofrimit të shërbimeve të orientuara drejt parandalimit, ndërhyrjes së hershme.</p>	<p>...dhe mbështetjes afatgjatë në trajtimin dhe menaxhimin e rastit.</p>	<p>NISMA ARSIS</p>		
<p>9. Objektivat prioritetet strategike</p> <p>1. Mbrojtja dhe mirëqenia e fëmijëve (fokus ndërsektorial)</p> <p>Objektivi Specifik 4, masa prioritare 3: Fuqizimi i kujdesit alternativ dhe deinstitutionalizimit</p>	<p>Sygjerohet të zgjerohet më tej se si do të fuqizohet kujdesi alternativ dhe deinstitutionalizimi</p>	<p>NISMA ARSIS</p>	<p>Pranuar plotësisht</p>	<p>Riformuluar si në vijim:</p> <p>Forcimi i kujdesit alternativ dhe transformimi i kujdesit rezidencial në shërbime alternative për fëmijët</p>
<p>9. Objektivat prioritetet strategike</p> <p>1. Mbrojtja dhe mirëqenia e fëmijëve (fokus ndërsektorial)</p> <p>Objektivi Specifik 4, masa prioritare 4. “Sigurimi i mbështetjes së sistemit për fëmijët</p>	<p>Sygjerohet të riformulohet, pasi nëse flasim për shërbime të specializuara të mbrojtjes, atëherë duhet të mbetet e përgjithshme, ose të përfshijë të gjithë grupet e fëmijëve në risk....</p> <p>Ndoshta duhet të jepet një shpjegim se çfarë nënkupton “ata në situata të jashtëzakonshme”</p>	<p>NISMA ARSIS</p>	<p>Pranuar plotësisht</p>	<p>Riformuluar si më poshtë:</p> <p>Sigurimi i mbështetjes së sistemit për fëmijët në situata migratore dhe të pashoqëruar, si dhe në institucionet rezidenciale.</p>
<p>Komente për situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuara</p>	<p>MEDPAK thekson në komente: (1) nevojën urgjente për rritjen e efektivitetit të qendrave sociale, pasi kapacitetet ekzistuese nuk shfrytëzohen plotësisht për shkak të mungesës së fleksibilitetit të orareve dhe angazhimit të stafit; (2) Vonohet</p>	<p>MEDPAK</p>	<p>Pranuar plotësisht</p>	<p>Komentet e MEDPAK nxjerrin në pah problematikat ekzistuese që prekin fëmijët me aftësi të kufizuara, çështje që adresohen nga Plani i Garancisë për Fëmijët përmes masave prioritare dhe veprimeve të</p>

	<p>mbështetja financiare për transportin, duke penguar pjesëmarrjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara; (3) Kërkohe koordinim më i mirë ndërinstucional, veçanërisht me Ministrinë e Arsimit për çështjet e mirëushqyerjes dhe edukimit. (4) Komisionet e vlerësimit bio-psiko-social kanë nevojë të rrisin kapacitetin dhe cilësinë e vlerësimeve, duke siguruar rekomandime të qarta dhe mbështetje psiko-sociale për prindërit. (5) Theksohet mungesa e mbështetjes për ndihmësit personalë (shpesh prindërit), të cilëve nuk u njihen vitet e punës. (6) Bashkitë nuk e trajtojnë me prioritet aftësinë e kufizuar dhe alokimet financiare janë minimale; kërkohet sigurimi i fondeve të detyrueshme për kujdesin ndaj fëmijëve. (7) nënvizon nevojën për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga institucionet publike.</p>			<p>parashikuara për secilën nga shtatë pikat kyçe të ngritura nga organizata.</p>
<p>Komente të përgjithshme për Planin</p>	<p>CRCA thekson nevojën që Plani të reflektojë më qartë pjesëmarrjen e fëmijëve dhe komuniteteve në tekstin kryesor; të ketë buxhete, tregues dhe kosto minimale të masave; si dhe të strukturojë më mirë mbështetjen psikosociale dhe qasjen e informuar nga trauma.</p> <p>Komentet nënvizojnë forcimin e qeverisjes dhe koordinimit, harmonizimin ligjor, përdorimin më të qartë të të dhënave bazë, si dhe vendosjen e mekanizmave operacionalë për mbrojtjen e fëmijëve,</p>	<p>CRCA</p>	<p>Pranuar plotësisht</p>	<p>Në tërësi çështjet e ngritura, veçanërisht ato që lidhen me mbështetjen psikosociale, shërbimet e kujdesit për adresimin e traumës, protokollet e referimit, mekanizmat e koordinimit vendor, edukimi dhe kujdesi në fëmijërinë e herëshme, si dhe masat për shëndetin, ushqyerjen dhe mbrojtjen, janë të përfshira në matricën e masave të Planit.</p> <p>PKV GF përfshin disa mënyra të detajuara e të strukturuara të monitorimit dhe reagimit/mbledhjes së mendimeve.</p>

	<p>edukimin e hershëm, arsimin, shëndetësinë dhe ushqyerjen.</p> <p>CRCA sugjeron gjithashtu modele bashkëpunimi me OShC-të, dashboards për monitorim dhe një përlllogaritje minimale të kostos së paketës së garancisë. Rekomandon gjithashtu përfshirjen më të dukshme të zërave të fëmijëve në kapitujt tematikë.</p>			<p>Sa i përket sugjerimeve për buxhetimin, indikatorët, harmonizimin ligjor, gjykojmë se janë të reflektuara qartë në tekst. Mirëpresim sugjerime/komente specifike.</p> <p>Lidhur me zërat e fëmijëve – mendimet e tyre janë përfshirë të përmbledhura në seksionin përkatës, por nuk e gjykojmë të nevojshëm përfshirjen e citimeve në seksionet kryesore të dokumentit politik. Për më tepër, qasja e ndjekur për mbledhjen e prezantimit të mendimeve të fëmijëve nuk lejon nxjerrjen e citimeve të drejtpërdrejta. Në rastin e zërave të prindërve kjo ka qënë më e thjeshtë për t'u bërë e janë përfshira në aneksin përkatës, në vijim të mendimeve të përmbledhura nga fëmijët.</p>
--	--	--	--	---